

## Politika e Sanksioneve

### Parashikime të Përgjithshme

Sanksionet janë të detyruara në rastet kur ka mangësi, mospërputhje ose shkelje të Standardeve. Ato janë masa korrigjuese të cilave operatori duhet t`u nënshtrohet.

### Kategoritë e Sanksioneve

Ekzistojnë kategori të ndryshme sanksionesh, të cilat varen nga shkalla e shkeljes së standardeve. Gjithashtu, edhe përfitimi potencial ose real dhe shtrirja e jo-konformiteteve, merren parasysh kur vendoset mbi kategorinë e sanksioneve. Gjithashtu do të merret parasysh edhe fakti nëse këto jo-konformitete kanë ndodhur me qëllim ose jo, të përsëritura dhe/ose nëse operatori është munduar të fshehë faktet. Kategoritë e sanksioneve janë të regjistruara në 5.3.002 Katalogun e sanksioneve. Sanksionet edhe mund të kombinohen.

### Detyrimi i sanksioneve

Vetëm Çertifikuesit mund të përcaktojnë sanksione.

Ata i caktojnë sanksionet bazuar në të dhënat e përshkruara në raportin e inspektimit, bazuar në rekomandimet e personelit të certifikimit, të drejtuar nga 5.3.002 Katalogu i Sanksioneve ose në rekomandimet e Komitetit të Apeleve.

Në procesin e vendimmarrjes do të të merren në konsideratë përfitimi ekonomik potencial ose real dhe masa e mos-konformitetit. Për më tepër, do të merren në konsideratë edhe fakti nëse ky mos-konformitet ndodhi me qëllim dhe nëse operatori u përpoq t`i fshehë faktet.

Nëse i njëjti mos-konformitet përsëritet, sanksioni i vënë do të jetë më i rëndë. Sanksionet mund të kombinohen, psh me vënien e një sanksioni shtesë inspektimi mund të vihet kusht dhe paralajmërim.

Operatorët do të informohen mbi sanksionet me shkrim pasi Certifikuesi vendos për certifikimin. Nëse një sanksion i vënë përfshin degradimin e një produkti, një grupi apo një parcele ose pezullimin apo tërheqjen e kontratës, licencës dhe certifikatës, letra e informimit për operatorin duhet të dërgohet me postë të regjistruar.

### Katalogu i Sanksioneve

5.3.002 Katalogu i Sanksioneve rregullon sesi duhet të punohet me mangësitë dhe jo-konformitetet ndaj Standardeve. Qëllimi i tij është t`i shërbejë personelit të certifikimit si një drejtues (guidë) dhe si një mjet për procesin e vendimmarrjes. Shkalla e sanksioneve do të përcaktohet gjatë procesit të vlerësimit dhe të certifikimit për çdo rast individual.

Ky katalog përmban shembuj të mangësive dhe jo-konformiteteve si ilustrime. Megjithatë rastet nuk janë të kufizuara në listën e dhënë në këtë katalog. Ky katalog do të rishikohet rregullisht nga personeli i certifikimit. Çdo ndryshim dhe/ose azhurnim duhet t`i transmetohet edhe Këshillit Administrativ të Albinspekt për informacion.

Dokumentet përkatëse:

QM 5 Sistemi i Certifikimit

PR 5.3.1 Certifikimi

5.3.002 Katalogu i Sanksioneve

5.3.006 Fleta e vlerësimit dhe certifikimit